STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 6 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON KOHEZGJATJE PER FAMILJET PER TE RIMARE CERTIFIKIMIN PER PERFITIMET E SNAP-IT PAS URAGANIT SENDI (URRICANE SANDY)

Pesë zona të tjera të NYC tani kanë të drejtë të marrin 50% të përfitimeve të tetorit për të zëvendësuar ushqimin e humbur nga stuhia

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut ka marë miratim nga Departamenti i Bujqësisë i SHBA-së (USDA) për të zgjatur periudhat e çertifikimit për familjet që janë duke marë përfitime të Programit të Ndihmës për Ushqim Shtesë (SNAP), të njohur më parë si Kuponat e Ushqimit, në mënyrë që këto familje të mos humbasin përfitimet e tyre për shkak të Uraganit Sendi (Hurricane Sandy). Sipas rregullave federale, familjet duhet të rimarrin çertifikim për të drejtën e tyre rregullisht që të vazhdojnë të marrin përfitimet e SNAP-it.

Qarqet e Qytetit të New York City e Nassau, Rockland, Suffolk, Westchester, Orange, Putnam e Sullivan tani mund të zgjasin me një muaj periudhat e çertifikimit për familjet e SNAP-it që pritet të përfundojnë në tetor dhe nëntor. Këto zgjatje do të ndihmojnë që të sigurojnë se familjet që nuk janë në gjendje të rimarrin çertifikimin në këtë kohë për shkak të Uraganit Sendi (Hurricane Sandy) nuk humbasin mundësinë e përdorimit të përfitimeve të SNAP-it. Kjo gjithashtu do të lehtësojë barrën administrative me të cilën përballen departamentet vendore të shërbimeve sociale të prekura, të cilat janë duke u rimëkëmbur nga katastrofa.

“Kjo zgjatje do t’u japë shtetasve të Nju Jorkut që marrin përfitime të SNAP-it në rajonet e goditura rëndë më shumë kohë për të rimarë çertifikimin për përfitime, në mënyrë që të mos humbasin të drejtën për shkak të stuhisë,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Përparësia jonë e menjëhershme është të ndihmojmë shtetasit e Nju Jorkut që të rimëkëmben sa më shpejt që të jetë e mundur dhe falënderoj USDA për ndihmën e tyre.”

Familjet periudhat e çertifikimit e të cilave janë zgjatur deri në nëntor do të kenë kohë deri në fund të nëntorit për të përfunduar rimarrjen e çertifikimit; ato periudha e çertifikimit e të cilave janë zgjatur deri në dhjetor do të kenë kohë deri në fund të dhjetorit. Shteti i Nju Jorkut dhe qarqet e prekura do të informojnë klientët për zgjatjen e periudhës së çertifikimit nëpërmjet njoftimeve publike.

Guvernatori Kuomo (Cuomo) sot njoftoi gjithashtu se marrësit e SNAP-it në pesë zona të tjera të Qytetit të Nju Jorkut tani kanë të drejtë të marrin automatikisht 50% të përfitimit mujor të SNAP-it të tyre për tetorin, për të zëvendësuar ushqimin e humbur si rezultat i stuhisë. Këto pesë zona (me kodet 10038, 11224, 11251, 10029 dhe 10039) janë duke iu shtuar listës së njoftuar më parë të 77 kodeve të zonave në Qytetin e Nju Jorkut dhe shtatë qarqeve të tjera.

Kodet e zonave të tjera në Qytetin e Nju Jorkut që përjetuan humbje të energjisë për një kohë të gjatë mund të shtohen ndërsa më shumë hollësi në lidhje me numrin e familjeve të prekura bëhen të disponueshme. Lista e azhornuar mund të gjendet këtu: http://otda.ny.gov/news/SNAP-replacements.pdf.

Marrësit në të gjitha pesë rrethet dhe në shtatë qarqet e tjera të prekura mund të blejnë ushqime të ngrohta dhe të përgatitura me përfitimet e tyre deri në fund të nëntorit, gjë që sipas rregulloreve federale zakonisht nuk lejohet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418